

Numri i lëndës: 2021:117136

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05491206

CP.nr.182/2021

Gjykata Themelore Gjilan dega e V.së, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Alush Sinani, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit J.S. nga fshati G., Komuna e V.së, të cilën e përfaqëson M.H., avokate në V., ndaj debitorit Komuna e V.së, Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike shpërblimin e tri pagave jubilarë, vlera e kontestit 1,593.75 gjykata jashtë seancës gjyqësore më datë 22.03.2024 bie këtë:

A K T V E N D I M

Përfundohet, procedura përmbarimore e kreditorit J.S. nga fshati G., Komuna e V.së, të cilën e përfaqëson M.H., avokate në V., ndaj debitorit Komuna e V.së, Drejtoria Komunale për Arsim.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore Gjilan dega e V.së, kishte lejuar propozimin me nr. CP.nr. 182/2021, të 14.06.2021, ndaj kreditorit J.S. nga fshati G., Komuna e V.së, të cilën e përfaqëson M.H., avokate në V., ndaj debitorit Komuna e V.së, Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike shpërblimin e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, në shumë prej 1,593.75 euro sipas dokumentit përmbarues akgjykimi C.nr. 113/2020 të datës 12.03.2021.

Gjykata , ka pranuar parashtresën nga ana e të autorizuarit të kreditores, nga e cila parashtresë ishte konfirmuar se debitori e ka përmbushur detyrimin në tërësi .

Gjykata pas vlerësimit të parashtresës konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, që të përfundohet procedura përmbarimore ndaj debitorit duke u bazuar në parashtresën e paraqitur, pranë kësaj Gjykate.

Pasi që gjykata ka konstatuar se debitori e kishte përmbushur detyrimin ndaj kreditorit, gjykata konform nenin 42 parag.2 dhe 66 parag. 4 të LPP-së, ka përfunduar procedurën duke vendosur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS V.
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL**

2021:117136, 22.03.2024

Gj y q t a r i

Alush Sinani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh
nga dita e pranimi të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.